



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 506/9 Prot.

Tiranë, më 19/09/2016

V E N D I M

Nr. 104, Datë 19/09/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE MBI
ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKO-FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimi mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, nga data 01.01.2014-30.04.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve është institucion i krijuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 532, datë 20.08.1996 dhe është në varësi të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

-Struktura drejtuese e DPUK, përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili emërohet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe nga dy zëvendësdrejtor të cilët propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohen nga Ministri.

-Këshilli Teknik (KT) është organ konsultativ i DPUK në zgjidhjen e çështjeve tekniko-shkencore të sistemit të furnizimit me ujë, kanalizimeve, trajtimit dhe pastrimit të tyre.

-Për periudhën janar-maj 2016, KT është mbledhur 6 herë dhe ka marrë po kaq vendime. Vendimet nuk janë mbajtur e regjistruar në përputhje me rregullat e përcaktuar për protokoll - arkivën. Lënia bosh dhe kapërcimi i numrave të vendimeve lë shkak për manipulime, si dhe për marrjen e vendimeve post faktum.

-Për të dy vitet u konstatua se pjesëmarrja në KT ka qenë kryesisht me përfaqësues të DPUK, ka munguar pjesëmarrja e përfaqësuesve nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Ndërtimit, Dega Hidroteknike; përfaqësues nga Instituti i Ndërtimit dhe nga Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit. Pjesëmarrja në mbledhjet e KT edhe të stafit akademik dhe ekspertëve të jashtëm, do të sjellë që vendimmarrja e DPUK të jetë e mbështetur në një oponentë më profesionale, në veçanti për projektet të cilat lidhen me investimet në zona turistike, të cilat për nga vetë zhvillimi paraqesin vështirësi për implementimin e projekteve (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve të marrë masa për të bërë të mundur që vendimet e Këshillit Teknik të mbahen konform rregullave të përcaktuar për protokoll-arkivën.

Gjithashtu DPUK dhe Drejtori i Përgjithshëm, të bëjnë të mundur që pjesëmarrja në mbledhjet e KT të jetë sa më e gjerë, duke përfshirë edhe përfaqësues nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Ndërtimit, Dega Hidroteknike; përfaqësues nga Instituti i ndërtimit dhe nga Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

DPUK nuk e ka përcjellë me shkresë zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës parashikimin e projektbuxhetit afatmesëm ose për buxhetin vjetor, veprim ky në kundërshtim me nenin 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

-Gjatë viteve objekt auditimi nga ana e DPUK ka pasur mjaft kërkesa për rialokime fondesh, edhe pse të arsyetuara, të cilat më pas janë miratuar nga MTI, duke sjellë një realizim të buxhetit, i cili qëndron larg parashikimit fillestar (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria Teknike e DPUK të merren masa që në vazhdimësi të dokumentojë dorëzimin dhe zbatimin e afateve kohore për hartimin e projektbuxhetit afatmesëm dhe vjetor në MTI.

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve të marrë masa me qëllim analizimin e treguesve gjatë parashikimit të buxhetit në mënyrë që realizimi të jetë sa më afër me parashikimin fillestar.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit u konstatua se, nuk është zbatuar parimi i ***të drejtave të konstatuara***, pra të regjistruhen transaksionet ekonomike pavarësisht faktit nëse shoqërohen me lëvizje të cash-it që do të thotë se regjistruhen të drejtat dhe detyrimet kur ato lindin. Aplikimi i këtij parimi (***të drejtave të konstatuara***), bën të mundur nxjerrjen në çdo moment dhe me saktësi në pasqyrat financiare, të vlerës së detyrimeve të lindura bazuar në kontratat fillestare si dhe vlerës së punimeve të kryera dhe të pranura.

Sipas të dhënave ekstra kontabël që disponon sektori i financës për financimin e kontratave deri më 31.12.2014 dhe 31.12.2015 për projektet me financim nga DPUK rezultojn se detyrimet e pa paraqitura në kontabilitet janë respektivisht 979,663,477 lekë dhe 552,517,253 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

- Drejtoria Ekonomike të marrë masa për pasqyrimin e saktë në kontabilitet dhe dhënien e shënimeve të plota shpjeguese për detyrimet sipas klasifikimit në afatshkurtër dhe afatmesëm që do të ndihmonte në planifikimin e drejtë të shlyerjes së tyre në buxhetet afatshkurtër dhe afatmesëm.

-Drejtoria Ekonomike të marrë masa për të bërë rregullimet kontabël që në Pasqyrat Financiare të institucionit të pasqyrohen jo vetëm detyrimet por dhe angazhimet e marra si detyrime jashtë bilancit, këto të fundit të shoqëruara me shënime të zgjeruara në pasqyrat financiare.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla u konstatuan se, DPUK nuk harton regjistrin e realizimit për procedurat me blerje të vogla, kjo në kundërshtim me nenin 7 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Praktikant shkresore të blerjeve me vlera të vogla, në lidhje me lindjen e nevojës për prokurimin e mallrave apo shërbimeve dhe gjendja aktuale të mallit në magazinën e institucionit në momentin e daljes së urdhrit të prokurimit, nuk janë të dokumentuar, veprime në kundërshtim me pikën 3, nenin 40 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- Për asnjë procedurë prokurimi me vlera të vogla nuk është arsyetuar vendosja dhe llogaritja e fondit limit në kundërshtim me nenin 57 dhe nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në të gjitha procedurat e kryera në formë shkresore me vlerë nën 100,000 lekë konstatohet se bashkëlidhur praktikave mungojnë 3 ofertat nga operatorët ekonomik të cilat janë të dokumentuara në procesverbalin e procedurës, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 40 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

Komisioni e prokurimit me vlera të vogla të marrë masa për dokumentimin e plotë dhe të saktë të procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla si dhe të tregojnë kujdes të veçantë në plotësimin e kërkesave të LPP, duke filluar me dokumentimin e nevojave për prokurim deri te operoret ekonomik që shpallen fitues.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla “Shërbim i ruajtjes së objektit” me urdhër prokurimi nr. 1 datë 03.03.2014 është konstatuar se janë skualifikuar 8 operatorë për një specifikim i cili nuk është pjesë e kërkesave fillestare.

- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla “Kryerja e shërbimit të internetit”, me urdhër prokurimi nr. 2 datë 03.03.2014 u konstatua se janë skualifikuar dy operatorë ekonomikë me arsyen e ofertës anomalisht të ulët, pa u kërkuar shpjegime operatorëve për këtë ofertë në kundërshtim me pikën 4/ç, kreu V, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar, “Për rregullat e prokurimit publik”.

- Në dy raste procedurash prokurimi me vlera të vogla është konstatuar se pas renditjes me vlerë të njëjtë të ofruar, është shpallur fitues një prej këtyre operatorëve ekonomikë pa u hedhur short, veprim në kundërshtim me pikën 4/ç, kreu V, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar, “Për rregullat e prokurimit publik”. Kjo parregullsi është konstatuar në procedurën me urdhër prokurimi nr. 4 datë 06.03.2014 për “Marrje ambient me qera për konferencë” me nr. prot. 532 dhe në procedurën me urdhër prokurimi nr. 11 datë 28.08.2014 për “Riparim automjeti” me nr. prot. 2040.
- Në 8 procedura prokurimi me vlera të vogla është konstatuar mungesa e procesverbalit të marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar. Kjo është në kundërshtim me procedurat e marrjes në dorëzim të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, si dhe pikën 6 të Udhëzimit nr. 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.
- Në procedurën e prokurimit me vlera të vogla “Kartolina zyrtare dhe kartëvizita” me urdhër prokurimi nr. 22 datë 24.12.2014 u konstatua se mallrat e prokuruar janë blerë të ndara nga njëra tjetra në kundërshtim me urdhrin e prokurimit të firmosur nga titullari i institucionit. Për këto dy mallra është përdorur procedura e blerjeve deri në 10,000 lekë, duke mënjanuar kështu procedurat standarde për prokurimin e blerjeve me vlera të vogla, duke shkaktuar në këtë mënyrë copëzim të fondit. Kjo është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, ku në pikën 3.
- Me anë të urdhër shpenzimit nr. 120 datë 19.05.2014 është blerë siguracioni i detyrueshëm TPL për automjetin e DPUK-së me targë TR P. Ky siguracion është prerë tek shoqëria e sigurimeve Nga auditimi u konstatua se sigurimi është pa procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve të marrë masa për zbatimin e procedurave dhe rregullave të prokurimit të mallrave apo shërbimeve me vlera të vogla në përputhje me ligjet dhe udhëzimeve përkatëse, duke analizuar tregun dhe në përputhje me nevojat e institucionit të hartojë specifikimet e nevojshme duke ju përmbajtur atyre në përcaktimin e fituesit.
- Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, të marrë masa që në vazhdimësi të dokumentojë veprimet e tij duke plotësuar procesverbale dhe duke dhënë shpjegime mbi zgjedhjet e bëra, si dhe të tregojë kujdes në marrjen në dorëzim të mallrave duke krijuar siguri të arsyeshme për përputhjen me kërkesat.
- Komisioni i prokurimit me vlera të vogla të marrë masa që në vazhdimësi për operatorët ekonomik që ofrojnë vlera të njëjta të ofertave, të ndjeke të gjitha praktikatat e përcaktuara në ligj.
- DPUK të marrë masa që në vazhdimësi të kryej procedurë prokurimi për blerjen e siguracioneve të makinave në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi:

- Janë konstatuar disa raste ku pagesa të ndryshme janë regjistruar me të njëjtin numër urdhër shpenzimi. Më saktë, urdhrat e shpenzimit me numrat 233, 264 dhe 385 janë të përsëritura nga dy herë, për shpenzime të ndryshme.
- Disa nga urdhër shpenzimet, si pasojë e anulimit të tyre, nuk janë pjesë e dosjeve. Gjithsesi ekzistenca e tyre është verifikuar dhe konfirmuar nga grupi i auditimit (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike e DPUK të marrë masa për të dokumentuar në mënyrë progresive dhe kronologjike veprimet me bankë, duke mos krijuar dublikime apo mungesa të numrave rendor të urdhër pagesave, në përputhje me rregullat e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi u konstatua se të gjithë urdhrat e shërbimeve të lëshuara nga Drejtori i DPUK-së, si dhe përmbledhja e shërbimeve të punonjësve janë pa numër protokolli dhe pa datë, veprime këto në kundërshtim me rregullat e dokumentimit në Udhëzimit nr 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në disa raste lëvizja e punonjësve është kryer pa urdhrin ose autorizimin paraprak të nënshkruar nga Drejtori i DPUK-së (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa që në vazhdimësi të bëjë dokumentimin e saktë të shërbimeve të kryera brenda vendit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi:

- Në mbajtjen e evidencave për lëvizjet e makinave dhe konsumit të karburantit, janë konstatuar parregullsitë e mëposhtme:

a- Nuk shënohet vlera fillestare e kilometrazhit të makinës në fillim të muajit dhe vlera përfundimtare e tij, por vetëm sasia e përshkuar e kilometrave. Kjo e bën të pamundur verifikimin nëse vlerat janë të sakta dhe në përputhjen me treguesin aktual të makinave.

b- Në lëvizjet e makinave për vitet 2014 dhe 2015 nuk shënohet personi udhëtues dhe as nënshkrim. Ndërsa për vitin 2016 (janar-prill) vetëm një pjesë e vogël e lëvizjeve janë të firmosura, por në asnjë rast nuk shënohet emri i punonjësit që ka përdorur mjetet (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa që në vazhdimësi të kryej dokumentimin e saktë të lëvizjeve të mjeteve, me qëllim reduktimin dhe shmangien e mangësive, në mënyrë që të rritet transparenca dhe rregullshmëria e konsumit të karburantit të mjeteve të DPUK.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i administrimit të marrëdhënieve të punës në DPUK rezulton se gjatë vitin 2014- 4 –mujorin e parë të vitit 2016, marrëdhëniet e punës janë rregulluar nga ligji i nëpunësit civil për 25 punonjës dhe me kod pune për 10 punonjës. Nga auditimi rezultuan disa mangësi në lidhje me:

- Rekrutimin e punonjësve, ku u konstatuan se ka 3 punonjës që janë punësuar pas kalimit të punonjësve me status që janë punësuar pa ju përmbajtur procedurave të punësimit të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, por me emërim nga Drejtori i Përgjithshëm. Duke mos zbatuar procedurat e nëpunësit civil janë shkelur parimet e përgjithshme të administrimit të shërbimit civil.

- Nuk janë hartuar përshkrimet e punës në kundërshtim me pikën 4.5 të rregullores së brendshme të miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 9, datë 28.0.2009 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve”.
- Procedurat e dhënies së masave disiplinore janë në kundërshtim me llojin e masave të parashikuara në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe me procedurat e përcaktuara në këtë ligj.
- Nga auditimi i praktikave të vlerësimit të punonjësve për vitin 2014 dhe 2015 rezultoi se për punonjësit e DPUK nuk u janë komunikuar objektivat në fillim të periudhës si dhe nuk janë bërë komunikimet 4-mujore me punonjësit në kundërshtim me pikën 8 dhe 12, kreu 2 të ligjit nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, gjithashtu në Drejtorinë e Monitorimit nuk është bërë vlerësimi periodik i punonjësve në kundërshtim me VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”.
- Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve personale të punonjësve u konstatua se dosjet janë të pa inventarizuara dhe të pa sistemuara, si dhe në brendësi të tyre ndodheshin disa kopje të dokumenteve. Në disa dosje mungojë disa dokumente personale të punonjësve dhe fleta prezantuese e dosjes është e pa firmosur në kundërshtim me Vendimin nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
- Për punonjësit që janë të punësuar me kod pune institucioni nuk ka një rregullore të brendshme mbi mënyrën e rekrutimit, dhënien e masave disiplinore, vlerësimin e punës etj.
- Gjithashtu konstatohet se Zyra e Burimeve Njerëzore ndodhet bashkë me Zyrën e Protokollit dhe sekretarisë së drejtorit të përgjithshëm dhe ruajtja e dosjeve në këtë zyrë nuk siguron ruajtjen e konfidencialitetit të dokumentacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në kundërshtim me Vendimin nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
- Në DPUK për periudhën e auditimit për pagesat e zbatimit të vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës të total është **4,873,453 lekë**, vlerë e cila përbën efekt negativ për buxhetin e shtetit për shkak të mos zbatimit të Kodit të Punës (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

- *Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për zbatimin e rregullave të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil, duke u bazuar mbi parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike. Për plotësimin e vendeve të lira të punës të njoftohet Departamenti i Administratës Publike sipas përcaktimeve Ligjin nr. 152/2013, datë 30.5.2013, i ndryshuar.*
- *Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për të miratuar përshkrimet e punës së punonjësve dhe çdo fillim periudhe punonjësve tu bëhen prezent objektivat e punës.*
- *Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për miradministrim të dosjeve personale të punonjësve duke i inventarizuar dhe sistemuar si dhe të krijohen kushtet për ruajtjen e të dhënave personale mbi bazën e parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.*
- *Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të brendshme mbi administrimin e marrëdhënieve të punës për punonjësit që në strukturën e DPUK janë me kod pune.*

- Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për miradministrim dhe zbatimin e procedurave ligjore për largimin e punonjësve nga puna duke shmangur penalizimin nga gjykatat, i cili për periudhën e auditimit është **4,873,453 lekë**, vlerë e cila përbën efekt negative për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

-Për periudhën objekt auditimi u konstatua se nga DPUK në cilësinë e Autoritetit Kontraktual, ka hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për prokurimet publike, regjistra të cilat janë miratuar nga MTI dhe janë dërguar në APP në zbatim të ligjit për PP.

-Për vitin 2014 nga regjistri i realizimit u konstatua se janë prokuruar 9 procedura në shumën gjithsej 56,694,097 lekë pa TVSH, ndërsa janë realizuar dhe lidhur kontrata për tre procedura në shumën 7,781,627 lekë pa TVSH, ose 48,912,470 lekë më pak se planifikimi ose realizuar investimet në masën 13.7%.

-Nga 9 procedura të planifikuara për vitin 2014 janë realizuar 4 të tilla, janë lidhur tre kontrata me OE të shpallur fitues, një procedure është anuluar për mungesë konkurrenca ndërsa 5 procedura nuk janë zhvilluar, pra nuk janë prokuruar. Nga këto 5 procedura dy janë procedura për studim projektim për KUZ (kanalizime ujëra të zeza) për zonën turistike të Spillesë dhe Gjirit të Lalzit, të cilat nuk janë prokuruar për arsye se është menduar që në këto investime të përfshihet edhe furnizimi me ujë (FU), dhe jo vetëm KUZ që është kërkuar nga ujësjellësit e këtyre dy zonave. Në fakt analiza e bërë nga DPUK duhej që të ishte bërë që fillim të hartimit të planit të investimeve, në fazën e planifikimit të buxhetit, në momentin kur bëhet analiza dhe shqyrtimi i kërkesave të mbërritura nga SHA-të e Ujësjellës Kanalizimeve. Nga mënyra e ndjekur për hartimin e investimeve rezulton se ai është bërë formal dhe jo i studiuar mirë.

Një procedure e pa prokuruar për vitin 2014 është ajo me objekt “Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatra rreth saj (shtesë kontrate). Arsyeja e mos realizimit të kësaj procedure është se nga UK SHA Kukës, nuk është plotësuar dosja teknike me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe shoqëria (UK SHA Kukës), e cila ka qenë përcaktuar nga DPUK të ishte AK për zhvillimin e procedurës, është tërhequr me arsyen se nuk e zhvillonte dot procedurën e prokurimit. Paralelisht me mos realizimin e kësaj procedure ka ecur edhe mosrealizimi i procedure së supervizionit për këtë investim.

Ndërsa procedura “Supervizion punimesh për objektin “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga pus-shpimet e Cermës, Loti II linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogozhinës pik.426 deri në pus-ndërprerjen Kavajë, depon ekzistuese”, nuk është prokuruar për arsye se nuk është përfunduar procedura e tenderit me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga pus-shpimet e Cermës, Loti II linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogozhinës pik.426 deri në pus-ndërprerjen Kavajë, depon ekzistuese”, procedure e cila ka qenë pezulluar deri në daljen e vendimeve gjyqësore.

-Për vitin 2015 nga regjistri i realizimit rezulton se janë realizuar dhe lidhur kontratat për 15 procedura prokurimi në shumën e vlerës së përlllogaritur të kontratës 1,763,738 mijë lekë pa TVSH, ndërsa shuma në total e kontratave të lidhura është 1,581,581 mijë lekë pa TVSH, ku diferenca midis fondit të prokuruar dhe atij të kontraktuar është 182,157 mijë lekë.

-Para lidhjes së kontratave objekt tenderimi të cilat kanë efekte financiare të konsiderueshme, nga ana e AK nuk është marrë këshilla nga Avokati i Shtetit e cila është detyrim ligjor në të tilla raste, bazuar në Ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” neni 2/2 dhe neni 5.

-Formularët e plotësuar nga anëtarët e NJP dhe KVO, për deklarinimin në lidhje me konfliktin e interes, për të gjitha procedurat e zhvilluara, janë të nënshkruar e firmosur dhe përcaktojnë

vetëm datën, por janë pa numër protokolli, duke bërë që këto formular të jenë formal, pasi në këtë formë si janë nënshkruar mund të plotësohen në çdo kohë (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe drejtoritë përkatëse të marrin masa që gjatë hartimit të planifikimit të procedurave të prokurimit, të bëjnë një analizë sa më të plotë dhe të studiuar, për investimet që do kryhen për furnizimin me ujë apo për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Gjithashtu DPUK të sigurojë marrjen e këshillimit nga Avokati i Shtetit, para lidhjes së kontratave, për investimet të cilat kanë vlera të konsiderueshme financiare.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

- Me vendimin e KT nr. 5 datë 30.05.2014, është miratuar në parim projekt preventivi i objektit “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ (shesë kontrate)”, me vlerë 7,565,130 lekë me TVSH.

Nga auditimi u kontaktua se në periudhën vitet 2012-2013, me fonde të buxhetit të shtetit, DPUK ka zhvilluar procedurën e prokurimit për kontratën me objekt “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza, Sarandë” dhe ka lidhur kontratën me BOE “.....” dhe “.....” sh.p.k kontratën nr. 2558 datë 03.10.2012 me vlerë 39,589,782 lekë me TVSH, kontratë e realizuar në vitin 2013 dhe është kolauduar më datë 04.09.2013.

DPUK pas një viti nga përfundimi i kontratës datë 03.10.2012, ka marrë në shqyrtim në mbledhjen e KT relacionin teknik pa date, pa numër protokolli nga subjekti “.....”, i cili ka qenë supervizori i kontratës fillestare, në të cilin pretendohet se gjatë zbatimit të kontratës së parë nuk është ndërtuar puseta tip ku parashikohej shkarkimi i tubacionit ekzistues plastik që transporton ujërat e zeza të qytetit të Sarandës.

Në dosjen teknike që shoqëron procedurën e prokurimit, mungon praktika ku është bërë evidentimi i problemit të rrjetit të dëmtuar. Nuk evidentohet nevoja për ndërhyrjen në rrjetin e dëmtuar, e cila duhet të ishte bërë që gjatë zbatimit të kontratës fillestare dhe të dokumentohej, si dhe nuk ka asnjë kërkesë apo relacion nga UK SHA Sarandë. Gjithashtu, në dosjen teknike mungon dokumentacioni që identifikon lindjen e nevojës për ndërhyrje në rrjet, si dhe delegimin e shqyrtimit të situatës nga supervizori.

Nga auditimi u konstatua se forma e prokurimit e përzgjedhur nga AK dhe koha se kur është aplikuar, janë të pabazuar ligjërisht dhe në kundërshtim me ligjin për PP dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreu IV pika 5/a.

Procedura e përzgjedhur nga AK dhe koha kur është zhvilluar, ka sjellë shmangie të konkurrencës, pasi punimet e shesës së kontratës në kohën kur është zhvilluar tenderi mund të kryenin edhe operator të tjerë ekonomik. Kjo formë prokurimi ka favorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë BOE SHA dhe sh.p.k, veprim ky në kundërshtim me LPP nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 1, pika 1, germa “ç”, ku përcaktohet se qëllimi i LPP është të nxisë konkurrencën midis OE.

- Nga auditimi për realizimin e kontratës të punimeve civile në objektin “Ndërtimi i Kolektorit të Ujërave të Zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ (Shesë kontrate)”, u konstatua se nga verifikimi i hartimit të projektit shesë me preventivin e shesës konstatohet se ka një mos sinkronizim të volumeve të punimeve. Përkatësisht volumet e gërmimit në projekt nuk janë të llogaritura saktë në preventiv, rrjedhimisht rriten sasi të disa zërave të tjerë, duke rritur fiktivisht fondin e vlerës së përlllogaritur të shesës së kontratës (*trajtuar më hollësisht në faqet 56-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

DPUK dhe Këshilli teknik të marrin masa që të ardhmen kur para miratimit të projekt-preventivit, të verifikojë volumet e punimeve të paraqitura nga projektuesi, me qëllim parandalimin e vlerave fiktive të përlogaritura të kontratave.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi:

-Me vendimin e KT nr. 3 datë 10.04.2015, është miratuar në parim projekt preventivi i objektit “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal Novoseje-Shishtavec-Mbroje, Komuna Shishtavec Kukës (shtesë kontrata)”, me vlerë 20,362,045 lekë me TVSH.

Nga supervizori “.....” shpk, më datë 03.04.2014 është paraqitur në DPUK relacioni teknik për shtesën e kontratës për punimet shtesë që duhet të kryhen për përfundimin e plotë të kontratës nr. 2555 datë 31.07.2012. Nga shqyrtimi i dokumenteve rezulton se gjatë zbatimit të kontratës, si nga supervizori dhe kontraktuesi nuk janë paraqitur dokumente që të tregojnë nevojën për shtesën e kontratës dhe për punime shtesë, pasi me përfundimin e kontratës fillestare nuk është arritur përfundimi i plotë i objektit. Kërkesa e supervizorit për punime shtesë është 5 muaj pas kolaudimit të objektit.

Nga sa më lart rezulton se nga supervizori, kontraktori dhe DPUK nuk është bërë një menaxhim i mirë i kontratës. Rruga e ndjekur nga supervizori për të kërkuar dhe për të vërtetuar nevojën e punimeve shtesë, si dhe miratimi i bërë nga DPUK për shtesën e kontratës, vërteton menaxhimin jo të mirë të kontratës fillestare, pasi çdo ndryshim duhet të bëhet gjatë zbatimit të punimeve.

Për shtesën e kontratës është nxjerr urdhër prokurimi nr. 1976 datë 10.07.2015, me fond limit 17,043,370 lekë pa TVSH, lloji i procedurës së prokurimit, me negociim pas shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Nga auditimi u konstatua se forma e prokurimit e përzgjedhur nga AK dhe koha kur është aplikuar, janë të pabazuar ligjërisht dhe në kundërshtim me ligjin për PP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pika 2/e të nenit 36, përcakton se autoriteti kontraktor mund të përdor formën e prokurimit “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, vetëm me kusht që kontrata të lidhet me kontraktorin **që po zbaton kontratën** dhe që vlera e plotë e kontratës shtesë të mos e tejkaloj 20% të vlerës së kontratës fillestare.

Kontrata për punimet shtesë është lidhur afërsisht 10 muaj pas kolaudimit të kontratës fillestare dhe jo në periudhën që kontraktori ka qenë duke zbatuar kontratën, madje edhe nevoja për shtesën e kontratës ka ardhur 5 muaj pas kolaudimit.

Procedura e përzgjedhur nga AK dhe koha kur është zhvilluar, ka sjell shmangie të konkurrencës, pasi punimet e shtesës së kontratës në kohë kur është zhvilluar tenderi mund ti kryenin edhe operator të tjerë ekonomik, në se procedura e prokurimit nuk do ishte negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Kjo formë prokurimi ka favorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë OE “.....” shpk, veprim ky në kundërshtim me LPP nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 1, pika 1, germa “ç”, ku përcaktohet se qëllimi i LPP është të nxisë konkurrencën midis OE.

-Nga auditimi u konstatua se edhe kontrata për supervizionin e objektit “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal Novoselë-Shishtavec-Mbroje, Komuna Shishtavec Kukës”, është bërë shtesë kontrate me vlerë 234,705 lekë pa tvsh dhe procedura e ndjekur është me negociim pa shpallje paraprake, për arsye se kontrata e supervizimit ecën paralelisht me kontratën e ndërtimit të objektit.

Kontrata nr. 2125 me OE “.....” shpk është lidhur më datë 24.07.2015 me afat dy muaj nga fillimi i punimeve (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

DPUK dhe Drejtoria Teknike të marrin masa për të bërë të mundur menaxhimin sa më të mirë të kontratave të lidhura për punime, me qëllim identifikimin e punimeve të paparashikuara të hasura gjatë zbatimit të kontratave dhe ndjekjen e praktikave ligjore për këto lloj punimesh, kjo me qëllim që lidhja e kontratave shtesë për punimet e ndërtimit, të jetë në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe LPP.

Menjëherë dhe vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi:

-Për gjashtë procedura prokurimi me objekt: “Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza në zonën e Ujit të Ftohtë Vlorë”, “Supervizion punimesh për objektin “Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza në zonën e ujit të ftohtë Vlorë”, “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem”, “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II”, “Furnizimi me ujë i fshatrave të Komunës Golem” dhe “Përmirësimi i furnizimit me ujë i zonës së plazhit, Lagja 13, Durrës”, kriteret e veçanta të kualifikimit, janë përcaktuar në kundërshtim me nenin 26, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kriteret e vendosura për të provuar përvojën e mëparshme, sjellin ulje të konkurrencës dhe rrjedhimisht ulje të pjesëmarrësve të OE, duke favorizuar vetëm ata OE që kanë kontrata punimesh për KUZ/FU, veprime në kundërshtim me pikën 2 germa “c” të nenit 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 46 të LPP pika 3 përcaktohet se kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

DPUK dhe Sektori Juridik dhe Prokurimeve të marrin masa që në të ardhmen, gjatë hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit për “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të zbatojë përcaktimet e sanksionuara në LPP dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, me qëllim shmangien e favorizimeve për OE dhe për të bërë të mundur rritjen e konkurrencës.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i procedurës së tenderit me objekt “Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj faza II”.

- Në kriteret e veçanta të kualifikimit në DST është kërkuar licencimin profesional të subjekteve juridike pika **N.P-11-A**, për ndërtime nënstacionesh, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, kriter i cili e kufizon pjesëmarrjen e OE në garën e tenderit, për arsye se kjo lloj licence nuk ndikon drejtpërdrejt në objektin kontratës, pasi për të realizuar punimet e kontratës kjo licencë nuk është e domosdoshme.

-Në kërkesën e pikës 2 në DST 2.3 “Kapaciteti teknik” është kërkuar përvojë e suksesshme në ekzekutimin punë të së njëjtës natyrë (ujësjellës), duke zvogëluar konkurrencën dhe duke ftuar në tender vetëm operatorë ekonomik të cilët kanë realizuar ujësjellës.

-Nga njësia e prokurimit nuk janë dhënë argumentimet apo sqarimet e vendosjeve të kriterëve të veçanta kualifikuese, ku kërkohen licenca profesionale, numri i punonjësve, mjetet etj, që të stimulojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për të penalizuar bashkimin e operatorëve ekonomik "....." & "....." sh.p.k, për arsyes se kanë deklaruar dokumentacion të rremë dhe të pasaktë në tender.
- Nga Autoriteti Kontraktor nuk ka një monitorim të vazhdueshëm për kontratat publike dhe nuk verifikohen periodikisht punimet në terren gjatë periudhave të pagesave pjesore (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga autoriteti kontraktor të merren masa që të ardhmen të argumentohet çdo kriter kualifikues, në përputhje me përcaktimet e sanksionuara në LPP, me qëllim shmangien e favorizimeve për OE dhe për të bërë të mundur rritjen e konkurrencës.

-Nga njësia e prokurimit të merren masa që licencat profesionale të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit, ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, të jenë në përputhje me qëllimin, dimensionet dhe format e objekteve.

-Nga Autoriteti Kontraktor në të ardhmen të merren masa që mos të kërkohen punë identike në zbatimin e kontratave publike, duke stimuluar pjesëmarrjen e vetëm disa operatorëve ekonomik dhe ulur konkurrencën.

-Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që të ardhmen, për subjekte të cilat paraqesin dokumentacion të rremë, të ndjek procedurat për njoftimin e APP për përjashtimin e këtyre subjekteve në tenderat publik, në përputhje me LPP.

- Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa, që të ardhmen të kryej monitorimin e vazhdueshëm të kontratave të punëve, ku të plotësohen dokumentacionet e objekteve. Specialistet të cilët administrojnë kontratat publike të verifikojnë periodikisht punimet në terren, me qëllim që të verifikojnë pagesat pjesore të situacioneve të punimeve.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit u konstatua se:

- Nuk është hartuar një rregullore e posaçme për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku të jenë të implementuara si dhe të kërkohet zbatimi i kërkesave të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

- Për sa i përket mjedisit të kontrollit, DPUK ende vazhdon të ketë rregulloren e brendshme të miratuar me Urdhrin nr. 93, datë 28.07.2009, në të cilën nuk dalin qartë funksionimi dhe misioni i Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe roli dhe detyrat sipas strukturave të kësaj drejtorie, rregullore e cila nuk është përditësuar me ndryshimet dhe përshtatjet me aktet dhe ndryshimet ligjore.

- Nuk ka hartuar një strategji, e cila duhet të përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Nuk janë përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

- Nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, si dhe nuk është hartuar një regjistër risku në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010

- Janë konstatuar mangësi në lidhje me pikat 4 dhe 5 të nenit 23 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-DPUK të marrë masa për hartimin e një rregulloreje të brendshme koherente, ku të dalin qartë funksionimi dhe misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, si dhe roli dhe detyrat sipas strukturave të kësaj drejtorie. Gjithashtu të hartojë një rregullore të posaçme ku të jenë të implementuara kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Titullari i DPUK të marrë masa që në vazhdimësi të hartojë një strategji e cila duhet të përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, si dhe të regjistrohen dhe raportohen masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

-Titullari i institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, si dhe të hartojë një regjistër risku me nenin 8 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

-DPUK të marrë masa që në vazhdimësi të tregojë kujdes të veçantë në dokumentimin e saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe në protokollimin e të gjithë dokumentacionit të domosdoshëm në përcaktimin e gjurmëve të procedurave të ndryshme të ndërmarra nga institucioni.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekti "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr.2 deri tek stacioni i pompave nr.4) bashkë me shtesën e kontratës",

-Kontrata e punimeve është lidhur nr. 2851 prot datë 29.12.2011 me OE “.....” sh.p.k. me vlerë 271,392,763 lekë me TVSH. Për realizimin e kësaj kontrate AK ka bërë shtesë kontrate më datë 29.10.2015 me vlerë 53,899,941 me TVSH. Leja e infrastrukturës është nxjerrë me nr. 800 prot datë 01.04.2013 dhe afati i lejes është deri më 28.03.2014. Me shkresën nr. 858 prot datë 03.04.2013 nga ish-Drejtori i Përgjithshëm i DPUK z.**P.K.** është dërguar leja e infrastrukturës operatorit ekonomik “.....” sh.p.k për dijëni edhe mbikëqyrësit të punimeve, ku u kërkon të merren masa për realizimin e punimeve sipas afatit të kontratës. Sa më sipër vërehet se operatori ekonomik ka kryer punime civile pa leje infrastrukture për një periudhë prej 5 muajsh, pasi nga ish-Drejtorin Ekzekutiv të DPUK z. **E. H.** është dorëzuar sheshi i ndërtimit datë 01.11.2012 dhe kanë lejuar fillimin e punimeve më 02.11.2012, veprime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”.

Gjatë periudhës së auditimit, u konstatuan diferenca punimesh të pakryera me vlerë **2,401,476** lekë me TVSH (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-DPUK të marrë masa që para se të bëjë çlirimin e garancisë së punimeve, të rakordojë për vlerën **2,401,476 lekë**, me OE “.....” sh.p.k si likuidim i punimeve të pakryera për kontratën me objekt “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti I Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr. 2 deri tek stacioni i

pompave nr. 4 bashkë me shtesën e kontratës, por të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi.

-Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen, të sigurojë lejen e ndërtimit dhe të ndjekë administrimin e këtyre lejeve, në përputhje me disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit dhe Rregulloreve së Zhvillimit të Territorit, me qëllim që mos të ketë vonesa në zbatimin e kontratave.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi:

- Nga Autoriteti Kontraktor nuk ka një monitorim të vazhdueshëm për kontratat publike dhe nuk verifikohen periodikisht punimet në terren gjatë periudhave të pagesave pjesore. Gjatë zbatimit të kontratës në objektin “*Furnizimi me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm*”, u konstatua:

- Kërkesat për shtyrje të punimeve nga kontraktoret dhe mbikëqyrësi i punimeve, nuk janë të argumentuara saktë duke u mbështetur me grafik punimesh, duke dhënë relacione argumentues për shtyrjet në funksion të afatit të kontratës. Në situacionet pjesore nuk janë mbajtur librezat masash pjesore, vetëm në situacionin përfundimtar pasqyrohet librezat e masave përmbledhëse.

- Gjatë verifikimeve në terren u konstatuan disa defekte të cilat kanë nevojë për korrigjim, pasi kontraktori është ende në periudhë garancie të objektit. Godina për impiantin e klorifikimit ndodhet në gjendje lagështie dhe myku, në të cilën është e nevojshme të rilyhet ose rikryet shërbetisja me gëlqere. Në disa zona të rrjetit të ujësjellësit, u konstatuan pjesë të tubacionit të pa mbuluara, ku duhen mbuluar-ngjeshur tubacioni sipas projektit. Në disa pjesë të shtresës asfaltike ku kalon gjurma e ujësjellësit, u konstatua se nuk është kryer shtresa asfaltike por vetëm shtresa e stabilizantit (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Autoriteti Kontraktor (DPUK) të merren masa që për defektet e punimeve të konstatuara nga grupi i auditimit, për kontratën me objekt “Furnizimi me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm”, nga operatori ekonomik “.....” sh.p.k të kryhet riparimi i tyre, para përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Gjatë zbatimit të kontratës në objektin “*Furnizimi me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm*”, u konstatua se, kontrata e punimeve është lidhur nr. 015.57.18 prot. datë 16.12.2008 me OE “.....” sh.p.k., me vlerë punimesh 161,881,813 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren u konstatuan diferenca punimesh të pakryera dhe zëra të pajustificuar me vlerë **4,335,948** lekë me TVSH e përfutuar padrejtësisht nga kontraktori “.....” sh.p.k. (*trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

*-DPUK të marrin masa për arkëtimin e vlerës **4,335,948 lekë**, nga OE “.....” sh.p.k., si dëm ekonomik i ardhur nga likuidimi i punimeve të pakryera për kontratën me objekt “Furnizimi*

me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm”, por të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së tenderit me objekt “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II”, u konstatuan se:

- Operatorit “.....” shpk me vlerë të ofertës të paraqitur 1,428,835 lekë pa TVSH, plotëson të gjitha kriteret por me shkresën nr. 801/1 datë 06.08.2015 është tërhequr nga procedura. Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk i është drejtuar kompanisë së sigurimit tek e cila operatori ka siguruar ofertën për të tërhequr vlerën e sigurimit të ofertës, duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i shkaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

-Për sa i përket arsyes së skualifikimit të operatorit “.....” shpk dhe pas verifikimit të certifikatave të tij ISO në faqen zyrtare të Rig-cert si dhe llojeve të certifikatave ISO që jepen nga ky institucion, si dhe kur jepen këto certifikata konstatojmë se arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik se nuk ka certifikatën ISO që nevojitet për punimet në ujësjellësa nuk qëndron pasi kjo certifikatë jepet për sektorë aktiviteti dhe jo specifikisht për lloj punimi, si pasojë skualifikimi i operatorit me ofertën 790,000 lekë dhe kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit me ofertën ekonomike më të lartë 1,800,000 lekë ka sjellë në buxhetin e DPUK por edhe për buxhetin e shtetit **dëmin ekonomik 1,010,000 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-DPUK të marrë të gjitha masat ligjore për arkëtimin e vlerës **37,443 lekë, vlerë e sigurimit të ofertës, ndaj OE “.....” shpk i cili është tërhequr nga procedura “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II”, pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave.**

-DPUK të marrë të gjitha masat ligjore për arkëtimin e vlerës **1,010,000 lekë, ndaj anëtarëve të KVO, F.M., L.T. dhe S.Z., për skualifikimin e padrejtë të OE “.....” nga procedura “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II” për mungesën e certifikatave ISO për punime në ujësjellësa.**

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi për realizimin e kontratës të punimeve civile në objektin “Ndërtimi i Kolektorit të Ujërave të Zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ (Shtesë kontrate)”, u konstatua se dosja teknike e projektit të azhurnuar, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar konstatohet se për; Zëri nr.2, 3.68/2a , Zëri nr.3, 2.261, Zëri nr.5, 2.19/a, janë konstatuar volume punimesh të pakryera, por të përfituara padrejtësisht nga kontraktori në shumën **53,929 lekë me TVSH shume e cila përbën dëm ekonomik** (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-DPUK të marrin masa për arkëtimin e vlerës **53,929 lekë, nga BOE “.....” dhe “.....”, si dëm ekonomik i ardhur nga likuidimi i punimeve të pakryera për shtesën e kontratës me**

objekt “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ (shtesë kontrate)”, por të përfituara padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të blerjes me vlera të vogla për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik komisioni ka skualifikuar operatorin e dytë dhe të tretë duke qenë se këta operator në ekstraktin e tyre nuk e ofrojnë këtë lloj shërbimi, nga verifikimi i ekstraktit të tyre konstatohet se OE ofron edhe shërbimin e riparimit të kompjuterëve dhe kamerave të sigurisë, pra ky operator është skualifikuar me pa të drejt nga KVO. Vlera **13,900 lekë përbën dëm ekonomik i shkaktuar nga KVO** (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

DPUK të marrë të gjitha masat ligjore për arkëtimin e vlerës **13,900 lekë** nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla, i përbërë nga z. **D.Z.**, znj. **V.Th.** dhe znj. **A.M.**, për skualifikimin e OE me pa të drejtë nga procedura e prokurimit “Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik”.

Menjëherë

C. SHPENZIME JO NË PËRPTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFICENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Për shpenzimet të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në të ardhurat e DPUK, duke sjellë një rëndim të kostove, pasi në realizimin e shpenzimeve që drejtoria duhet të kryejë nuk është zbatuar parimi i 3E-ve, Ekonomicitet, Efektivitet dhe Efiçencë.

1. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr. 2 deri tek stacioni i pompave nr.4) bashkë me shtesën e kontratës”.

-Nga shqyrtimi i gjashtë situacioneve, u konstatua se në situacionet pjesore rezultojnë se janë realizuar të gjitha punimet, ndërsa në situacionin përmbledhës përfundimtar nr. 6, rezultojnë se për 31 nyje të kanalizimeve vlera e tyre është zeruar, gjë e cila tregon se punimet nuk janë kryer ashtu siç janë deklaruar në situacionet pjesore. Vlera e këtyre nyjeve në situacionin përfundimtar përmbledhës është shpërndarë në punimet e realizuara për nyjet e tjera (duke shtuar volumet e punimeve dhe zëra të rinj), në një kohë që në situacionet pjesore punimet e këtyre nyjeve janë deklaruar të përfunduara. Nga auditimi i dosjes së zbatimit, observacionet e sjella dhe verifikimi në terren u konstatua se nyjet e përfunduara në kontratën fillestare, janë për arsye se gjatë zbatimit të kontratës fillestare janë kryer punime shtesë të pa parashikuara (të cilat kanë dalë gjatë punimeve), por që kanë qenë të domosdoshme që të kryheshin, pasi mos realizimi i tyre rrjedhimisht sillte dhe mos realizimin e nyjeve në fjalë. Nga DPUK dhe supervizori ky fakt nuk është dokumentuar plotësisht si dhe për punimet shtesë nuk është marrë miratimi, veprime të cilat kanë sjellë që vlera **46,645,507 lekë** me TVSH të shkaktojë shpenzime jo në përputhje me parimin e 3-E-ve, ekonomikitetit, efektivitetit dhe efiçencës (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Teknik të marrë masa që në të ardhmen propozimet dhe kërkesat e mbikëqyrësve të kontratave për punime shtesë, të shqyrtohen me profesionalizëm me qëllim që të bëhet e mundur menaxhimi sa më i mirë i kontratave, duke zbatuar parimin e 3-E, ekonomikitetit efektivitetit dhe eficiencës.

Në vazhdimesi

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së tenderit me objekt "Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem", u konstatuan se OE ".....", është skualifikuar sepse nuk ka eksperiencë shërbimi të ngjashme por bazuar në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit, ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", në lidhjen 3 të kategorive në fushta e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit shihet se punimet e zbatimit në ndërtim, jepen shpjegimet e kategorive të përgjithshme të ndërtimit dhe mbikëqyrja e veprave hidroteknike (NP-6), ka më shumë kërkesa dhe kritere se mbikëqyrja e ujësjellsave (NP-7). Skualifikimi i operatorit "....." është i padrejtë pasi edhe pse kriteri i vendosur është diskriminues kontratat për shërbime të ngjashme të paraqitura nga operatori janë më shumë se mbikëqyrje ujësjellsash, ky skualifikim i padrejtë i këtij operatori ka sjellë pasojë **efekt negativ për buxhetin e DPUK dhe buxhetin e shtetit në vlerën 1,051,000 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Njësia e Prokurimit të marri masa që në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit të vendos kritere kualifikimi të tilla që të mos diskriminojë operatorët ekonomik por të nxisë pjesëmarrjen si dhe komisioni i vlerësimit të ofertave të vlerësojë me kujdes dokumentet e paraqitura nga OE duke shmangur kualifikimet e padrejta dhe efektet negative për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i administrimit i marrëdhënieve të punës në DPUK rezulton se gjatë vitin 2014 deri 4 – mujor 2016 janë kryer pagesa për zbatimin e vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës të total është **4,873,453 lekë**, vlerë e cila përbën efekt negative për buxhetin e shtetit për shkak të mos zbatimit të Kodit të Punës (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

*-Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa për miradministrim dhe zbatimin e procedurave ligjore për largimin e punonjësve nga puna duke shmangur penalizimin nga gjykatat, i cili për periudhën e auditimit është **4,873,453 lekë**, vlerë e cila përbën efekt negative për buxhetin e shtetit.*

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi për administrimin e marrëdhënieve të punës në DPUK për periudhën objekt auditimi u konstatuan mangësi në zbatimin plotësimin e strukturës organizative të institucionit, konkretisht:

- Në strukturën organizative ekzistuese janë parashikuar dhe ushtrojnë funksionet 2 pozicione Zv/Drejtorë të Përgjithshën, pavarësisht se numri total i punonjësve është 35, çka bie në kundërshtim me pikën 15, të VKM nr. 474, datë 16.6.2011, dy pozicionet e zëvendësistullarit nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në këtë vendim me një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit për vitin 2014 prej 608,400 lekë.

- Nga mos zbatimi i vendimit të mësipëm në Drejtorinë Teknike ushtrojnë veprimtarinë e tyre Sektori i Programimit me 2 punonjës dhe Sektori Juridik me dy punonjës. Po kështu në Drejtorinë Ekonomike ushtrojnë veprimtarinë e tyre sektori i Financës me 2 punonjës dhe sektori i investimeve me 2 punonjës, në Drejtorinë e Monitorimit ushtrojnë veprimtarinë 2 sektor me 6 vete në përbërje, ku sektori i Monitorimit të Projekteve & Faqes së Internetit përbëhet nga 2 vetë. Sipas strukturës dhe organikës e cila duhej të rishikohej rezulton se 5 sektorë nuk plotësojnë kriterin për të pasur Përgjegjës Sektori, me një efekt financiar për vitin 2014 672,000 lekë, 672,000 lekë për vitin 2015 dhe 224,000 lekë për 4-mujorin e parë 2016. Sa më lart, nga mos zbatimi dhe mos përshtatja e strukturës organizative të DPUK me standardet e përcaktuara në këtë vendim, rezulton se për periudhën objekt auditimi është shkaktuar një përdorim joefektiv i fondeve buxhetore në shumën rreth 2,176,400 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

DPUK të marri masa të plotësojë strukturën organizative të institucionit ku çdo sektor që krijohet të ketë në përbërje të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës duke shmangur përdorimin jo efektiv të fondeve buxhetore, pasi për periudhën objekt auditimi mos plotësimi i strukturës ka sjell një përdorim jo efektiv të fondeve në vlerën 2,176,400 lekë, duke sjellë nefekt negativ.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në neni 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, kërkojmë te ndëshkohen për kundërvajtje administrative:

1. A.T. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në shumën 100 mijë lekë për arsye se:

Në kontratën e punimeve civile në objektin "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr.2 deri tek stacioni i pompave nr. 4) bashkë me shtesën e kontratës", është përgjegjës për mos saktësinë dhe mos vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit, në përputhje me neni 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. Nga këto parregullsi, gjatë zbatimit të kësaj kontrate janë shkaktuar shpenzime jo në përputhje me parimin e 3-E-ve, ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficiencës, në shumën 46,645,507 lekë.

2. D.Q. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në shumën 100 mijë lekë, për arsye se:

Në kontratën e punimeve civile në objektin "Furnizimi me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm", është përgjegjës për mos saktësinë dhe mos vërtetësinë dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit, në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. Nga

këto parregullsi, gjatë zbatimit të kësaj kontrate është shkaktuar dëm ekonomik në shumën 4,335,948 lekë.

3. B.D. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në shumën 50 mijë leke për arsye se:

Në kontratën e punimeve civile në objektin “Ndërtimi i Kolektorit të Ujërave të Zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ (Shtesë kontrate)”, është përgjegjës për mos saktësinë dhe mos vërtetësinë e dokumenteve në përputhje nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Nga këto parregullsi, gjatë zbatimit të kësaj kontrate është shkaktuar dëm ekonomik në shumën 53,929 lekë.

E. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenet 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115 date 5.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të DPUK, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

a) “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, neni 58 pika b, për:

1 .Z. G.A. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe në cilësinë e kryetarit të KVO, për arsye se:

-Nuk ka bere një analize të plote me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive për mos realizimin e planit të investimeve për vitin 2014, ku u konstatua se, nga regjistri i realizimit janë prokuruar 9 procedura në shumën gjithsej 56,694,097 lekë pa TVSH, ndërsa janë realizuar dhe lidhur kontrata për tre procedura në shumën 7,781,627 lekë pa TVSH, ose 48,912,470 lekë më pak se planifikimi ose realizuar investimet në masën 13.7%.

Nga 9 procedura të planifikuara për vitin 2014 janë realizuar 4 të tilla, janë lidhur tre kontrata me OE të shpallur fitues, një procedure është anuluar për mungesë konkurrenca ndërsa 5 procedura nuk janë zhvilluar, pra nuk janë prokuruar. Nga këto 5 procedura dy janë procedura për studim projektim për KUZ (kanalizime ujëra të zeza) për zonën turistike të Spillesë dhe Gjirit të Lalzit, të cilat nuk janë prokuruar për arsye se është menduar që në këto investime të përfshihet edhe furnizimi me ujë (FU), dhe jo vetëm KUZ që është kërkuar nga ujësjellësit e këtyre dy zonave. Në fakt kjo analizën e bërë nga DPUK duhej që të ishte bërë që fillim të hartimit të planit të investimeve, në fazën e planifikimit të buxhetit, në momentin kur bëhet analiza dhe shqyrtimi i kërkesave të mbërritura nga SHA-të e Ujësjellës Kanalizimeve. Nga mënyra e ndjekur për hartimin e investimeve rezulton se ai është bërë formal dhe jo i studiuar mirë.

-Në tenderin me objekt “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem”, si kryetar i KVO ka skualifikuar pa të drejtë operatorin “.....” sepse edhe pse kriteri i vendosur është diskriminues kontratat e paraqitura për shërbime të ngjashme nga operatori janë më shumë se mbikëqyrje ujësjellsash, ky skualifikim i padrejtë i këtij operatori ka sjellë pasojë efekt negativ për buxhetin e DPUK dhe buxhetin e shtetit në vlerën 1,051,000 lekë.

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr. 2 deri tek stacioni i pompave nr. 4) shtesë kontratës”. Ka miratuar procedurën e shtesës së

kontratës me procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në kushtet kur ka realizuar kolaudimin e objektit dhe në shfrytëzim, si rrjedhojë realizimi i shtesës së kontratës nuk kanë qenë në rrethana të paparashikuara.

-Si anëtar i grupit të kolaudimit për kontratën "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr. 2 deri tek stacioni i pompave nr. 4) shtesë kontratës" nuk ka konstatuar pa rregullsitë e dokumentacionit teknik të dosjes së punimeve, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 3/c, përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Pika 3/ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes. Veprime të cilat kanë shpenzime jo në përputhje me parimin e 3E-ve, ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficiencës për buxhetin e shtetit në shumën **46,645,507** lekë.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.5 datë 15.07.2016; nr.6 date 15.07.2016; nr. 8 datë 15.07.2016; ne akjtverifikimet nr.2 datë 15.07.2016, nr. 3 datë 15.07.2016).

2. Z. L.T. në cilësinë e anëtarit të KVO për arsye se:

Në procedurën me urdhër prokurimi nr. 1769, datë 18.06.2015 me objekt "Supervizion punimesh për objektin "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës – Kavajë nga pusshpimet e Çermës, Loti II: (Linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogozhinës pik 426 deri në pus-ndërprerje Kavajë, linja e ujësjellësit pus-ndërprerje deri në depon Kavajë)", operatori i shpallur fitues nuk i përmbush kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit, dhe si i tillë, duhet të ishte skualifikuar.

- Në tenderin me objekt "*Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II*", kanë skualifikuar pa të drejtë OE "....." shpk duke shkaktuar dëmin ekonomik 1,010,000 lekë.

- Nuk i janë drejtuar kompanisë së sigurimit të ofertës duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i shkaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Si anëtar i grupit të kolaudimit për kontratën me objekt "*Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr. 2 deri tek stacioni i pompave nr. 4) shtesë kontratës*". nuk ka konstatuar pa rregullsitë e dokumentacionit teknik të dosjes së punimeve, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 3/c, përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Pika 3/ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.4 datë 15.07.2016; nr.8 datë 15.07.2016 dheaktverifikimi nr.4 datë 15.07.2016).

3. Z. A.M. në cilësinë e anëtarit të KVO për arsye se:

Në procedurën me urdhër prokurimi nr. 896, datë 20.03.2015 me objekt "Supervizion punimesh për objektin "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës – Kavajë nga pusshpimet e Çermës, Loti I: Dublimi i pusshpimeve ekzistuese, rikonstruksion i stacionit qëndror dhe ndërtimi i rezervuarit 1000 m³, linjat e ujësjellësit pusshpime – stacion qëndror, linjat e ujësjellësit stacioni qëndror deri në Rrogozhinë Pik 426, rikonstruksion i linjave elektrike",

operatori i shpallur fitues nuk i përmbush kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit, dhe si i tillë, duhet të ishte skualifikuar.

-Në tenderin me objekt “*Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem*” kanë skualifikuar pa të drejtë operatorin “.....” sepse edhe pse kriteri i vendosur është diskriminues kontratat e paraqitura për shërbime të ngjashme nga operatori janë më shumë se mbikqyrje ujësjellsash, ky skualifikim i padrejtë i këtij operatori ka sjellë pasojë **efekt negativ për buxhetin e DPUK dhe buxhetin e shtetit në vlerën 1,051,000 lekë.**

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.5 datë 15.07.2016 dhe aktverifikimi nr.3 date 15.07.2016).

4. Z. I. me detyre specialit ne Drejtorinë Teknike dhe ne cilësinë e kolaudatorit te punimeve, për arsye se:

- Si anëtar i grupit të kolaudimit për kantatën me objekt “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr.2 deri tek stacioni i pompave nr.4) shtesë kontratës”, nuk ka konstatuar pa rregullsitë e dokumentacionit teknik të dosjes së punimeve, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit” pika 3/c, përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Pika 3/ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

-Nuk ka dokumentuar plotësisht punimet shtese te kryera, për kontratën me objekti “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr.2 deri tek stacioni i pompave nr.4) shtesë kontratës”, si dhe nuk ka monitoruar ne vazhdimësi pagesat pjesore te punimeve, veprime të cilat kanë sjellë shpenzime jo në përputhje me parimin e 3-E-ve, ekonomikitetit, efektivitetit dhe eficiencës për buxhetin e shtetit në shumën **46,645,507 lekë.**

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr. 8 datë 15.07.2016).

b) “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 pika c për:

1. znj. F. B. me detyre specialiste në sektorin Juridik dhe Prokurimeve për arsye se:

-Për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit rajonal Novosej-Shishtavec-Mbroje, Komuna Shishtavec Kukës” forma e prokurimit e propozuar dhe koha se kur është aplikuar, janë të pabazuar ligjërisht dhe në kundërshtim me ligjin për PP dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 e ndryshuar, kreu IV pika 5/a. Kontrata për punimet shtesë është lidhur afërsisht 10 muaj pas kolaudimit të kontratës fillestare dhe jo në periudhën që kontraktori ka qenë duke zbatuar kontratën, madje edhe nevoja për shtesën e kontratës ka ardhur 5 muaj pas kolaudimit dhe është **shtesë kontrate dhe jo kontratë e re**, si dhe përdorimi i mundshëm i procedurës të përcaktuar sipas pikës 2/e të nenit 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fillestare dhe AK duhet të vlerësojë koston e përgjithshme të përllogaritur të ndërtimeve në vijim. Kjo formë prokurimi ka favorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë OE “.....” shpk, veprim ky në kundërshtim me LPP nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 1, pika 1, germa “ç”, ku përcaktohet se qëllimi i LPP është të nxisë konkurrencën midis OE.

-Për gjashte procedura prokurimi, në pikën 2 të DST “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 1 “Përvojë e suksesshme në ekzekutimin”, është përcaktuar se punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë të jetë KUZ me stacion

pompimi, po kështu është përcaktuara edhe për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (KUZ) me stacione pompimi, për tre vitet e fundit. Përcaktimi i këtyre kriterëve të kualifikimit, është në kundërshtim me nenin 26, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kriteret e vendosura për të provuar përvojën e mëparshme, sjellin ulje të konkurrencës dhe rrjedhimisht ulje të pjesëmarrësve të OE, duke favorizuar vetëm ata OE që kanë kontrata punimesh për KUZ, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 germa “c” të nenit 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se qëllimi i Gjithashtu në nenin 46 të LPP pika 3 përcaktohet se kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve.

- Nuk janë drejtuar kompanisë së sigurimit të ofertës duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i shkaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

-Në tenderin e zhvilluar me objektin "Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj faza II " për administratën viti 2015:

Është kërkuar si kriter kualifikues pika e licencës N.P-11-A, ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ku konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, e cila nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe kanë zvogëluar konkurrencën.

Është kërkuar si kriter kualifikues përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) në një vlerë prej 75,000,000 dhe pikës b) Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë të paktën 300,000,000 lekë pa TVSH

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Përmirësimi i furnizimit me ujë i zonës së plazhit, Lagja 13, Durrës”, është kërkuar si kriter kualifikues përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) në një vlerë prej 83.000.000 dhe pikës b) Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë të paktën 332,000,000 lekë pa TVSH.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.4 datë 15.07.2016; nr.5 datë 15.07.2016; nr.7 datë 15.07.2016 dhe aktverifikimet nr.6, 8, 11,12 datë 15.07.2016).

2. Z. K.B. në cilësinë e anëtarit të KVO për arsye se:

-Në procedurën me urdhër prokurimi nr. 896, datë 20.03.2015 me objekt “Supervizion punimesh për objektin “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës – Kavajë nga pusshpimet e Çermës, Loti I: Dublimi i pusshpimeve ekzistuese, rikonstruksion i stacionit qëndror dhe ndërtimi i rezervuarit 1000 m³, linjat e ujësjellësit pusshpime – stacion qëndror, linjat e ujësjellësit stacioni qëndror deri në Rrogozhinë Pik 426, rikonstruksion i linjave elektrike””, operatori i shpallur fitues nuk i përmbush kërkesat e dokumentave standarde të tenderit, dhe si i tillë, duhet të ishte skualifikuar.

-Në tenderin me objekt “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i fshatrave të komunës Golem” kanë skualifikuar pa të drejtë operatorin “.....” sepse edhe pse kriteri i vendosur është diskriminues kontratat e paraqitura për shërbime të ngjashme nga operatori janë më shumë se mbikëqyrje ujësjellsash, ky skualifikim i padrejtë i këtij operatori ka sjellë pasojë efekt negativ për buxhetin e DPUK dhe buxhetin e shtetit në vlerën 1,051,000 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr. 5 date 15.07.2016 dhe aktverifikimin nr.3 datë 15.07.2016).

3. Z. F.M. në cilësinë e anëtarit të KVO për arsye se:

Në procedurën me urdhër prokurimi nr. 1769, datë 18.06.2015 me objekt “Supervizion punimesh për objektin “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës – Kavajë nga pusshpimet e Çermës, Loti II: (Linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogzhinës pik 426 deri në pus-ndërprerje Kavajë, linja e ujësjellësit pus-ndërprerje deri në depon Kavajë)”, operatori i shpallur fitues nuk i përmbush kërkesat e dokumenteve standarde të tenderit, dhe si i tillë, duhet të ishte skualifikuar.

- Në tenderin me objekt “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II”, kanë skualifikuar pa të drejtë OE “.....” shpk duke shkaktuar dëmin ekonomik 1,010,000 lekë.

- Nuk i janë drejtuar kompanisë së sigurimit të ofertës duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i skaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr.4 datë 15.07.2016 dhe aktverifikimin nr.4 nr.4 datë 15.07.2016).

4. Z. S.Z. në cilësinë e anëtarit të KVO për arsye se:

Në procedurën me urdhër prokurimi nr. 1769, datë 18.06.2015 me objekt “Supervizion punimesh për objektin “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës – Kavajë nga pusshpimet e Çermës, Loti II: (Linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogzhinës pik 426 deri në pus-ndërprerje Kavajë, linja e ujësjellësit pus-ndërprerje deri në depon Kavajë)”, operatori i shpallur fitues nuk i përmbush kërkesat e dokumentave standarde të tenderit, dhe si i tillë, duhet të ishte skualifikuar.

- Në tenderin me objekt “Supervizion punimesh për objektin furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj, faza II”, kanë skualifikuar pa të drejtë OE “.....” shpk duke shkaktuar dëmin ekonomik 1,010,000 lekë.

- nuk i janë drejtuar kompanisë së sigurimit të ofertës duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i shkaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr.4 datë 15.07.2016 dhe aktverifikimin nr.4 datë 15.07.2016).

5. Znj. A. Y., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit:

- Nuk janë drejtuar kompanisë së sigurimit të ofertës duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i skaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj faza II”, është kërkuar si kriter kualifikues pika e licencës N.P-11-A, ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ku konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, e cila nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe kanë zvogëluar konkurrencën.

Është kërkuar si kriter kualifikues përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) në një vlerë prej 75,000,000 dhe pikës b)

Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë të paktën 300,000,000 lekë pa TVSH, kriter i cili ka ulur konkurrencën, ne kundërshtim me ligjin për PP.

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Përmirësimi i furnizimit me ujë i zonës së plazhit, Lagja 13, Durrës”, është kërkuar si kriter kualifikues përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) në një vlerë prej 83.000.000 dhe pikës b) Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë të paktën 332,000,000 lekë pa TVSH, kriter i cili ka ulur konkurrencën, ne kundërshtim me ligjin për PP.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr. 4, 5 datë 15.07.2016 dhe aktverifikimet nr.6, 11,12 datë 15.07.2016).

c) “Vërejtje”, neni 58 pika a për:

1. Znj. A.M.,

2. Z. D.Z.,

3. Z. V.Th., në cilësinë e anëtarëve të KVO për blerjet me vlera të vogla, për arsye se:

-Në procedurat me urdhëra prokurimi nr. 1 datë 03.03.2014 për “Shërbim i ruajtjes së objektit” dhe nr. 2 datë 03.03.2014 për “Kryerja e shërbimit të internetit” kanë skualifikuar pa të drejtë operatorë ekonomikë me ofertë ekonomike më të favorshme.

- Në procedurat me urdhëra prokurimi nr. 4 datë 06.03.2014 për “Marrje ambient me qera për konferencë” dhe nr. 11 datë 28.08.2014 për “Riparim automjeti”, kanë skualifikuar operatorë ekonomikë me ofertë të njëjtë me operatorin fitues, pa u hedhur short në kundërshtim me pikën 4/ç, kreu V, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, i ndryshuar “Për rregullat e prokurimit publik”.

- Në tetë procedura prokurimi me vlera të vogla nuk kanë mbajtur procesverbale të marrjes në dorëzim në kundërshtim me procedurat e marrjes në dorëzim të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, si dhe pikën 6 të Udhëzimit nr. 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- Në procedurën me urdhër prokurimi nr. 22 datë 24.12.2014 për “Kartolina zyrtare dhe kartëvizita” kanë konstatuar copëzim të fondit duke sjellë ndryshim të procedurës në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pika 3.

- Nuk kanë zbatuar afatin për dorëzimin e regjistrimit të parashikimeve të blerjeve me vlera të vogla.

- Nuk kanë hartuar regjistrin e realizimit për procedurat me blerje të vogla, kjo në kundërshtim me nenin 7 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në asnjë rast nuk kanë dokumentuar lindja e nevojë për prokurimin e mallrave apo shërbimeve dhe gjendja aktuale e mallit në magazine e institucionit në momentin e daljes së urdhrimit të prokurimit, gjithashtu për asnjë procedurë prokurimi me vlera të vogla nuk është arsyetuar vendosja dhe llogaritja e fondit limit në kundërshtim me nenet 40, 57 dhe 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në të gjitha procedurat e kryera në formë shkresore me vlerë nën 100,000 lekë konstatohet se bashkëlidhur praktikave mungojnë tre ofertat nga operatorët ekonomik të cilat janë të dokumentuara në procesverbalin e procedurës, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.1, dhe nr.2 datë 15.07.2016).

4.zj. V.R., Përgjegjëse Sektori të Burimeve Njerëzore, për arsye se:

- Nuk ka zbatuar procedura që duhet të ndiqet për plotësimin e vendeve të lira sipas Ligjin nr. 152/2013, datë 30.5.2013, i ndryshuar.

- Nuk ka marrë masa për hartimin e objektivave dhe komunikimin e tyre në fillim të periudhës si dhe nuk janë bërë komunikimet 4-mujore me punonjësit në kundërshtim me pikën 8 dhe 12, kreu 2 të ligjit nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil".

- Nuk ka bërë inventarizimin e dosjet personale, të cilat janë të pa inventarizuara dhe të pa sistemuara në brendësi të tyre ndodheshin disa kopje të dokumenteve dhe të ngatërruara. Në disa dosje mungojë disa dokumente personale të punonjësve dhe fleta prezantuese e dosjes është e pa firmosur në kundërshtim me vendimin nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrir qendror të personelit".

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr.3 datë 15.07.2016).

II. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, dhe kontratës individuale, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a) "Vërejtje me shkrim", për:

1. z. P.SH., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve DPUK për arsye se:

Për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i ujësjellësit rajonal Novosej-Shishtavec-Mbroje, Komuna Shishtavec Kukës" forma e prokurimit e propozuar dhe koha se kur është aplikuar, janë të pabazuar ligjërisht dhe në kundërshtim me ligjin për PP dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 e ndryshuar, kreu IV pika 5/a. Kontrata për punimet shtesë është lidhur afërsisht 10 muaj pas kolaudimit të kontratës fillestare dhe jo në periudhën që kontraktori ka qenë duke zbatuar kontratën, madje edhe nevoja për shtesën e kontratës ka ardhur 5 muaj pas kolaudimit dhe është **shtesë kontrate** dhe **jo kontratë e re**, si dhe përdorimi i mundshëm i procedurës të përcaktuar sipas pikës 2/e të nenit 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fillestare dhe AK duhet të vlerësojë koston e përgjithshme të përlogaritur të ndërtimeve në vijim. Kjo formë prokurimi ka favorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë OE "....." shpk, veprim ky në kundërshtim me LPP nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 1, pika 1, germa "ç", ku përcaktohet se qëllimi i LPP është të nxisë konkurrencën midis OE.

-Për gjashtë procedura prokurimi, në pikën 2 të DST "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 1 "Përvojë e suksesshme në ekzekutimin", është përcaktuar se punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë të jetë KUZ me stacion pompimi, po kështu është përcaktuara edhe për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (KUZ) me stacione pompimi, për tre vitet e fundit. Përcaktimi i këtyre kriterëve të kualifikimit, është në kundërshtim me nenin 26, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë", pasi kriteret e vendosura për të provuar përvojën e mëparshme, sjellin ulje të konkurrencës dhe rrjedhimisht ulje të pjesëmarrësve të OE, duke favorizuar vetëm ata OE që kanë kontrata punimesh për KUZ, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 germa "c" të nenit 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se qëllimi i Gjithashtu në nenin 46 të LPP pika 3 përcaktohet se kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve.

- Nuk janë drejtuar kompanisë së sigurimit të ofertës duke qenë se operatori ka tërhequr ofertën pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, duke i shkaktuar institucionit **dëmin ekonomik me vlerë 37,443 lekë** në kundërshtim me neni 49 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe 14 fshatrave rreth saj faza II”, është kërkuar si kriter kualifikues pika e licencës N.P-11-A, ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ku konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, e cila nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe kanë zvogëluar konkurrencën, në kundërshtim me ligjin për PP.

Është kërkuar si kriter kualifikues përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) në një vlerë prej 75,000,000 dhe pikës b) Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë të paktën 300,000,000 lekë pa TVSH, e cila nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe kanë zvogëluar konkurrencën, në kundërshtim me ligjin për PP.

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Përmirësimi i furnizimit me ujë i zonës së plazhit, Lagja 13, Durrës”, është kërkuar si kriter kualifikues përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) në një vlerë prej 83.000.000 dhe pikës b) Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë (ujësjellës) vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë të paktën 332.000.000 lekë pa TVSH, e cila nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe kanë zvogëluar konkurrencën, në kundërshtim me ligjin për PP.

- Në tenderin e zhvilluar me objektin “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën Përroi i Agait-Qerret, Loti i I (Fshati Golem, Linjat KUZ Stacioni i pompave nr.2 deri tek stacioni i pompave nr.4) shtesë kontratës”, ka miratuar procedurën e shtesës së kontratës me procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në kushtet kur vepra ka qenë e kolauduar dhe në shfrytëzim, si rrjedhojë realizimi i shtesës së kontratës nuk kanë qenë në rrethana të paparashikuara.

(Trajtuar më hollësisht në procesverbalet nr.4, 5,6,7,8 dhe aktverifikimet nr.6,8,11 dhe 12 datë 15.06.2016).

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për z. R.K., në cilësinë e anëtarit të KVO për blerjet me vlera të vogla për të cilën nuk rekomandojmë masë disiplinore duke e konsideruar të ezauruar, për arsye se ky person nuk është në marrëdhënie pune me DPUK.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R